



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:263916

Datë: 27.12.2024

Numri i dokumentit: 06661966

C.nr.2023:263917

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil, me gjyqtarin Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditësit K.M nga Ferizaj, të cilat sipas autorizimit e përfaqëson av. Nazmije Ibrahim avokat nga Ferizaj, kundër të paditurës Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës – SHSKUK me seli në Prishtinë, Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj, me objekt kontesti, kompensimin e pagës së 13-të, jashtë seancës, me datë 27.12.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET NË TËRËSI SI E PABAZUAR kërkesëpadia e paditësit K.M, përmes së cilës ka kërkuar që të detyrohet e paditura Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës – SHSKUK me seli në Prishtinë Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj që paditësit në emër të pagës së 13-të për vitin 2018,2019,2020,2021,2022 t’ia paguajë shumën prej 2304,54 euro, të gjitha me kamatë ligjore prej 8% nga data e dorëzimit të padisë në gjykatë e deri në pagesën definitive.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me datë 01.12.2023 ka paraqitur padi ndaj të paditurës për kompensimin e pagave të 13-ta për fund vitin 2018,2019,2020,2021,2022. Në padi ka theksuar se paditësi është i punësuar në Spitalin e Përgjithshëm në Ferizaj, si infermiere e përgjithshme – teknike e anestezië. Ka shtuar se baza juridike e kërkesëpadisë për pagesën e pagës së 13-të mbështetet në Kontratën Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë ku në nenin 17 par.2 është përcaktuar se paditësi ka të drejtë në kompensim të pagës së 13-të për çdo vit kalendarik. Në rastin konkret e paditura nuk i ka kompensuar paditësit pagat e 13-ta për vitet kalendarike të kërkuara.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura në përgjigje në padi, e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, si për nga baza ashtu edhe lartësia. Në përgjigje në padi ndër tjera theksohet se kompensimi i pagës së 13-të nuk është paraparë me Ligjin e Punës Nr.03/L-212, ndërsa tutje është cituar neni 90 par.5 i këtij ligji, duke pretenduar se në rastin konkret e paditura SHSKUK nuk është palë nënshkruese e marrëveshjes në të cilën mbështetet kërkesëpadia e paditëseve. Tutje e paditura i është referuar dispozitës nga neni 17 par.2 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë si dhe mendimit juridik të Gjykatës Supreme të dt. 09.10.2023, duke vlerësuar se në mënyrën se si është formuluar dispozita e lartcekur, çështja e kompensimit të pagës së 13-të për punëtorët shëndetësorë është e kushtëzuar me mundësitë financiare të punëdhënësit, e në rastin konkret e paditura bazuar në buxhetin e ndarë për paga nuk ka pasur mundësi për kompensimin e pagës së 13-të sipas kërkesës së paditësit.. Bazuar në këto pretendime, i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave, kërkesëpadinë e paditësve ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

Me rastin e pranimit të përgjigjes në padi, gjegjësisht vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse e në lidhshmëri me vlerësimin e provave të bashkangjitura, kjo Gjykatë erdhi në përfundim se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, rrjedhimisht nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e një vendimi meritor mbi refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit pa caktuar fare seancë gjyqësore, në kuptim të dispozitës nga neni 399 par.1 dhe 2 të LPK-së, e cila përcakton: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia. Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura.”*

Nga provat e bashkangjitura në padi, Gjykatës i rezulton se mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie të punës me të paditurën në bazë të kontratës së punës të dt. 06.09.2018 me nr.320 ku rezulton se paditësi është i sistemuar në pozitën infermiere e përgjithshme – teknike e anesteziës. Lidhur me pagën bazë të paditësit, gjykata gjen se nga lista e pagave të buxhetit të Kosovës të bashkëngjitura në shkresat e lëndës vërtetohet se paditësit realizon pagë bazë 425€.

Fakti vendimtar për tu vërtetuar nga ana e Gjykatës në këtë çështje juridike kontestimore, konsiston në vlerësimin e faktit nëse ekzistojnë mundësitë buxhetore të paditurës në raport me përmbushjen e detyrimit ndaj paditëses konform nenit 17 par.2 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, mbi bazën e të cilit paditësja e mbështet themelësinë e kërkesëpadisë.

Fillimisht, duhet sjellë në vëmendje se Kontrata Kolektive Sektoriale, e lidhur ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Kosovës, në njërin anë dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, në anën tjetër, ka hyrë në fuqi me dt.11.06.2018, me rastin e nënshkrimit nga ana e palëve. Afati i vlefshmërisë së kësaj Kontrate është 3 (tre) vite, në kuptim të dispozitës nga neni 90 par.4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, në të cilën shprehimisht përcaktohet: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet.”*

Çështja e kompensimit të pagës së 13-të për çdo vit kalendarik, është e përcaktuar me dispozitën nga neni 17 par.2 të kësaj Kontrate, ku parashihet që: *“Punëmarrësi ka të drejtë në kompensimin e pagës së 13 (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit.”*

Nga interpretimi i dispozitës së lartcekur, rrjedh se kemi të bëjmë me detyrim të kushtëzuar, që nënkupton se e drejta e paditëses si punëmarrës i të paditurës për të realizuar një kompensim të tillë është thelbësisht e lidhur nga mundësitë buxhetore të kësaj të fundit. Në këtë mënyrë, bazuar në rregullat mbi barrën e të provuarit në procedurë, u takon palëve ndërgjyqëse që në çdo fazë të procedurës, përmes provave të bashkangjitura t’i provojnë pretendimet e tyre. Pala paditëse duhet ta provojë që përveç faktit që i plotëson kushtet e përcaktuara për të realizuar të drejtën në kompensimin e pagës së 13-të për vitin kalendarik përkatës, kanë ekzistuar edhe mundësitë buxhetore të palës së paditur për kompensimin e një kërkesë të tillë. Në anën tjetër, e paditura në cilësinë e punëdhënësit në çdo fazë të procedurës mund të deklarohet me prova konkrete lidhur me çështjen e mundësive buxhetore për përmbushjen e obligimit në fjalë. Në funksion të një interpretimi të tillë, Gjykata iu referua edhe Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, GJ.A.Su.A.nr.40/2023, të datës 27.02.2023 për zbatimin e Kontratës Kolektive Sektoriale lidhur me kërkesat e pagës së 13-të të punëtorëve të shëndetësisë.

Në këtë drejtim, sipas Ligjit nr. 07/1-001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, Gjykata ka konstatuar se kufiri i buxhetit për paga dhe mëditje për SHSKUK për vitin 2020 ka qenë 57,190,922 euro. Ndërsa sipas Ligjit nr. 07/1-014 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit me nr.07/1-001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 kufiri i buxhetit në kategorinë për paga dhe mëditje është rritur në vlerën prej 61,101,647 euro. Sipas nenit 12 par. 6 të këtij Ligji është përcaktuar se *“Shpenzimi i parave publike nga kategoria e shpenzimeve mallra dhe shërbime nuk është i lejuar për pagesën e punonjësve, qoftë në formë të shtesave apo si kontribute në mall, përfshirë këtu shujtat apo dhuratat, duke përjashtuar rimbursimin apo shpenzimet e lejuara për udhëtimet jashtë vendit, sipas legjislacionit përkatës.”*

Tutje, nga raporti publik i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës për vitin 2020, i publikuar në muajin korrik 2021 nga Zyra Kombëtare e Auditimit, gjykata ka konstatuar faktin se buxheti fillestar i SHSKUK në kategorinë paga dhe mëditje ka qenë 57,190,921.00 euro, buxheti final 76,308,249.55 euro, ndërsa shpenzimet për vitin 2020 kanë qenë 76,249,758.81 euro. Sipas sqarimeve nga raporti i auditimit buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 19,117,328 dhe ndryshimet kanë ndodhur me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi ndarjet Buxhetore për vitin 2020 (3,910,725€) dhe me vendim të Qeverisë (15,206,603€) kryesisht për shtesa mbi pagën bazë pas situatës së krijuar me Covid.

Përmes përgjigjes në padi, pala e paditur ka bashkangjitur njoftimit të shefit të Financave të Spitalit të Përgjithshëm të Ferizajt të dt. 25.10.2023 si dhe njoftimit të dt. 21.12.2023 të drejtorit financiar të Ministrisë së Shëndetësisë – SHSKUK. Në bazë të vështrimit të këtyre provave

materiale, Gjykata vëren se e paditura gjatë vitit kalendarik 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022 ka disponuar me buxhet të kufizuar në raport me përmbushjen e obligimeve që kanë të bëjnë me pagat e të punësuarve në këtë institucion.

Në këtë kuptim, Gjykata ka vërtetuar faktin se e paditura nuk disponon mjete të mjaftueshme buxhetore në raport me përmbushjen e obligimit për kompensimin e pagës së 13-të për vitin kalendarik 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022, që njërherit paraqet objekt shqyrtimi të kësaj çështje kontestimore. Kësisoj, bazuar këto arsye, rrjedh se paditësja nuk mund t'i shfrytëzoj beneficionet e përcaktuara me dispozitën nga neni 17 par.2 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë lidhur me kërkesën për pagesën e pagës së 13-të.

Andaj, për arsyet e dhëna në këtë aktgjykim, pasi që gjykata ka konstatuar se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadsisë, ka vendosur që të refuzojë në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit.

Vendimin që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta të procedurës nga pika II e dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata e ka mbështetur në dispozitën ligjore nga neni 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Mbi bazën e të lartcekurave, në mbështetje të dispozitave nga nenet 143.1 dhe 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil  
C.nr.2023:263917 datë 27.12.2024

Gjyqtari  
Armend Ahmeti

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.